REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

Zyra e Bashkëqeverisjes dhe Performancës

Nr.307/2 Prot. Maliq, më 02/02/2026

Lënda: Kthim përgjigje

I nderuar z. Ibrahimllari,

Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, të protokolluar pranë Bashkisë Maliq me Nr.307 Prot,datë 22.01.2026, në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", ju informoj si më poshtë, në cilësinë e Koordinator për të Drejtën e Informimit:

Në përputhje me detyrimet ligjore për transparencën institucionale, vendimet e Këshillit Bashkiak Maliq publikohen dhe vihen në dispozicion të publikut në mënyrë të vazhdueshme, pa pagesë, në faqen zyrtare të Bashkisë Maliq, si dhe në portalin zyrtar **vendime.al**, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Sipas nenit 7 dhe nenit 10 të Ligjit nr. 119/2014, roli i Koordinatorit për të Drejtën e Informimit konsiston në administrimin procedural të kërkesave për informacion, orientimin e kërkuesve mbi mënyrat e aksesimit të informacionit publik dhe garantimin e transparencës, pa ushtruar kompetenca verifikuese apo certifikuese mbi përmbajtjen, ekzistencën ose vlefshmërinë e akteve administrative konkrete.

Verifikimi i ekzistencës, mungesës, identifikimit dhe administrimit të vendimeve të Këshillit Bashkiak përbën kompetencë funksionale të strukturave të Këshillit Bashkiak, që vepron në bazë të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe rregullores përkatëse të funksionimit të Këshillit Bashkiak.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, mbetem në dispozicion për çdo informacion shtesë në përputhje me kompetencat ligjore.

Konceptoi: Koordinatori për të Drejtën e Informimit A.firanj

KRYETARI I BASHKISË
GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ